

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË
NOTER BESA M. NELAJ

DATE 21/03/2020
NR REP 953



VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 21/03/2020, para meje Notere BESA M. NELAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën SULEJMAN DELVINA, 9 KATESHE, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:


Madena Deromemaj, person fizik regjistruar në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L86703210R, ; me seli ne Vlore, me adresë Rruga Sulejman Delvina, Lagjja Hajro Çakerri, Objekt nr.19, kati 1, përfaqësuar nga Administratori Madena Deromemaj, atësia Musa, amësia Liri, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë, Vlorë dhe banuese në VLORE, me adresë 9401 Vlorë Rajoni 1,L."Partizani" 0, lindur më 19/10/1970, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 024579882 dhe nr. personal H06019075T.

Përkthyesja është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, ie cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur: "Deklarate ne baze te nenit 46 dhe 47 D.P.R.n.445/2000", "Proces verbal i Asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme me nr rep 151580 dhe kol 21899", "Ekstrakt i zakonshem shoqeri me kapital", "Themelim i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar" nga gjuha Italisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"; në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroi se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
BESA M. NELAJ



DEKLARATE NE BAZE TE NENIT 46 dhe 47 D.P.R. n. 445/2000

I nenshkruari -----

-PALLARO BRUNO, lindur në San Giorgio in Bosco (PD), me 15 maj 1959 me banim në San Giorgio in Bosco (PD) në Rrugën Romanie n. 550; -----

Ne cilesine e Administratorit te Vetëm dhe Perfaqesues Ligjor i shoqërisë: -----

"COSTRUZIONI INDUSTRIALI CIVIDAC S.P.A." me seli ligjore në San Biagio di Callalta (TV), fraksioni Cavrie, Rruga Borgo Cattanei n. 35, me kapital aksionar Euro 104.000,00 (njëqind e katër mijë presje zero zero) i derdhur plotësisht, e regjistruar pranë C.C.I.A.A. (D.H.T.I.A.B, *sh.i.p*)* te Treviso-Belluno në n. TV-160031 R.E.A. dhe në n. 01639460268 të kodit tatimor dhe regjistrimit në Regjistrin e Ndërmarrjeve; -----

i vetëdijshem për sanksionet penale te parashikuara nga neni 76 i Dekretit Presidential n. 445/2000, në rast te deklarimeve false ose që përmbajnë të dhëna që nuk korrespondojnë me të vërtetën si dhe formimin ose përdorimin e akteve false, duke marrë parasysh informacionin në përputhje me nenin 13, Dekreti Legjislativ 196/2003, referuar formularit te aplikimit për financim

DEKLARON

nën përgjegjësinë e tij

se shoqëria "COSTRUZIONI INDUSTRIALI CIVIDAC S.P.A." me të dhëna si me sipër ----

- është regjistruar rregullisht me nr. 01639460268 dhe ne numin REA TV-160031 te Regjistrin te Ndermarrjeve te Treviso-Belluno; -----
- gëzon ushtrimin e plotë dhe të lirë të të gjitha të drejtave të saj, duke mos qenë në likuidim, as duke iu nënshtruar procedurave të falimentimit, rënë dakord për preventivin ose administrimin e kontrolluar;
- se akti i themelimit është kopje e njejte me origjinalin;
- se ekstrakti i dhomës është kopje e njejte me origjinalin;
- se statuti i bashkelidhur është statuti aktual dhe është një kopje e njejte me origjinalin;
- se administrimi i shoqërisë i është besuar administratorit të vetëm z. PALLARO BRUNO me të dhëna si me sipër, deri në revokim;

(Firma)



AUTENTIFIKIM I NËNSHKRIMIT

Vërtetoj, une e nënshkuara Dr. VALENTINA PONZI, Noter në Maserà' di Padova (PD), me zyrë në rrugën Conselvana n. 151/E, regjistruar ne Dhomën e Rrethit Noterial te Padova, se zoti -----

-PALLARO BRUNO, lindur në San Giorgio in Bosco (PD), me 15 maj 1959 me banim në San Giorgio in Bosco (PD) në Rrugën Romanie n. 550; -----

Ne cilësinë e Administratorit te Vetëm dhe Përfaqësues Ligjor i shoqërisë:

"COSTRUZIONI INDUSTRIALI CIVIDAC S.P.A." me seli ligjore në San Biagio di Callalta (TV), fraksioni Cavrie, Rruga Borgo Cattanei n. 35, me kapital aksionar Euro 104.000,00 (njëqind e katër mijë presje zero zero) i derdhur plotësisht, e regjistruar pranë C.C.I.A.A. (D.H.T.I.A.B, *sh.i.p*)* te Treviso-Belluno në n. TV-160031 R.E.A*. dhe në n. 01639460268 të kodit tatimor dhe regjistrimit në Regjistrin e Ndërmarrjeve; -----

për identitetin personal te te cilit, aftësinë për te vepruar, kompetencat dhe kualifikimin, une Noteri jam i sigurt, ka dhene deklaratën e mësipërme dhe e ka nënshkuar ne praninë time. ---
Ne Maserà' di Padova, rruga Conselvana n. 151/E, 10 (dhjete) janar 2020 (dymijë e njëzet)

Nënshkuar ne orën 11.00

(vula, nënshkrimi)

*Shënim i përkthyesit

R.E.A* -Repertorio Economico Amministrativo- Repertor Ekonomik Administrativ



CANTIERE NOTARILE
VLORE



(Vula)

PREFEKTURA E REPUBLIKËS - PRANË GJYKATËS SE
PADOVA
APOSTILE

(Konventa e Hagës e 5 tetor 1961)

1. Shteti: REPUBLIKA ITALIANE

Ky akt publik

2. është nënshkruar nga VALENTINA PONZI

3. i cili vepron si NOTER NE PADOVA

4. mban vulën e Se Njëjtës

VËRTETUAR

5. në Padova

6. më 14 Janar 2020

7. nga PROKURORIA

8. me numrin 118

9. Pulla

10. PROKURORI I REPUBLIKËS

Dr. Antonio Cappellari

(nënshkrimi)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
PËRKTHYES ZYRTAR

Deklaroj se teksti ne gjuhen shqip eshte i njëjtë me tekstin ne gjuhen italiane, e eshte kryer nga znj. Madena Deromamaj, përkthyes zyrtar i akredituar pranë Ministrisë se Drejtësisë.

Madena Deromamaj

ALBANIA 2/19

DICHIARAZIONE AI SENSI DEGLI ARTT 46 e 47 DPR n. 445/2000

Il sottoscritto: _____

- PALLARO BRUNO nato a San Giorgio in Bosco (PD) il 15

maggio 1959 e residente a San Giorgio in Bosco (PD) in Via

Romanie n. 550, _____

nella sua qualità di Amministratore Unico e Legale

Rappresentante della società: _____

"COSTRUZIONI INDUSTRIALI CIVIDAC S.P.A." con sede legale in

San Biagio di Callalta (TV), frazione Cavrie, Via Borgo

Cattanei n. 35, capitale sociale Euro 104.000,00

(centoquattromila virgola zero zero) interamente versato,

iscritta presso la C.C.I.A.A. di Treviso-Belluno al n°

TV-160031 R.E.A. e al n. 01639460268 di codice fiscale ed

iscrizione al Registro delle Imprese _____

consapevole delle sanzioni penali previste dall'art. 76 del

DPR n. 445/2000 in caso di dichiarazioni mendaci o

contenenti dati non rispondenti a verità e di formazione o

suo di atti falsi, preso atto delle informazioni ai sensi

dell'art. 13, D. Lgs 196/2003, di cui al modulo di domanda

del finanziamento _____


_____ DICHIARA _____

_____ sotto la propria responsabilità _____

che la società "COSTRUZIONI INDUSTRIALI CIVIDAC S.P.A.",

come sopra generalizzata: _____

- è regolarmente iscritta al n. 01639460268 e al n. REA



TV-160031 del Registro Imprese di Treviso-Belluno;

- gode del pieno e libero esercizio di tutti i suoi diritti,
non essendo in liquidazione, né trovandosi sottoposta a
procedure di fallimento, concordato preventivo o
amministrazione controllata;

- che l'atto costitutivo è copia conforme all'originale;

- che la visura camerale è copia conforme all'originale;

- che l'allegato statuto è lo statuto vigente ed è copia
conforme all'originale;

- che l'amministrazione della società è affidata
all'amministratore unico signor PALLARO BRUNO, sopra
generalizzato, sino a revoca.

Pallaro Bruno

AUTENTICA DI FIRMA

Certifico io sottoscritta Dott.ssa VALENTINA PONZI, Notaio
in Maserà di Padova (PD), con studio in Via Conselvana n.
151/E, iscritta nel Collegio Notarile del Distretto di
Padova, che il signor

- PALLARO BRUNO nato a San Giorgio in Bosco (PD) il 15
maggio 1959 e residente a San Giorgio in Bosco (PD) in Via
Romanie n. 550,

nella sua qualità di Amministratore Unico e Legale
Rappresentante della società:

"COSTRUZIONI INDUSTRIALI CIVIDAC S.P.A." con sede legale in

San Biagio di Callalta (TV), frazione Cavrie, Via Borgo

Cattanei n. 35, capitale sociale Euro 104.000,00

(centoquattromila virgola zero zero) interamente versato,

iscritta presso la C.C.I.A.A. di Treviso-Belluno al n°

TV-160031 R.E.A. e al n. 01639460268 di codice fiscale ed

iscrizione al Registro delle Imprese

della cui identità personale, capacità di agire, poteri e


qualifica io Notaio sono certo, ha reso la sopraestesa

dichiarazione e l'ha sottoscritta alla mia presenza.

In Maserà di Padova, Via Conselvana n. 151/E, 10 (dieci)

gennaio 2020 (duemilaventi)

Sottoscritto alle ore 11,00





PROCURA DELLA REPUBBLICA PRESSO IL TRIBUNALE DI PADOVA
APOSTILLE
(Convenzione de la Haye du 5 octobre 1961)

1. Stato Repubblica Italiana

Il presente atto pubblico

2. E' stato firmato da VALENTINA PONZI

3. operante in qualità NOTAIO IN PADOVA

4. è munito del bollo di SE STESSA

Attestato

5. in Padova 6. il 14 GEN. 2020

7. da Procura 10. Firma

8. cod. N. 118 il PROCURATORE DELLA REPUBBLICA
dott. Antonino Cappellari

9. Bollo

Dott. DOMENICO CURIONE
NOTER
31100 TREVISO – Piazza Pola 7
Tel. (04322) 582320 – Fax 583087
Kodi Fiskal CNR DNC 42B10 E038D

Regjistruar në Treviso
Më 15 Tetor 2004

Nr. Rep. 151580

Nr. Kol. 21899

REPUBLIKA ITALIANE
PROCES VERBAL I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË JASHTËZAKONSHME

Në vitin 2004 dymijë e katër, dita e 28 njëzet e tetë Shtator në orën 18 tetëmbëdhjetë

Në Treviso, në zyrën time në Sheshi Pola 7.

Me kërkesë të Këshillit Administrativ


“KONSTUKSIONE INDUSTRIALE CIVIDAC SHA”* me seli në San Biagio di Callalta (TV),
Rruga Borgo Cattanei nr. 35, fraksion Cavrie,

Kodi Fiskal 01639460268

Kapitali i shoqërisë 104.000,00 Euro (njëqind e katër mijë presje zero zero), regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Treviso me nr. 01639460268, dhe me qëllim që të përfshijë në aktet e mia proces verbalin e asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme të Ortakëve të së njëjtës Shoqëri, në këtë ditë, orë dhe vendndodhje.

Përpara meje dottor Domenico Curione, noter në Treviso, regjistruar në Kolegjin Noterial të qarkut Treviso, pa asistencën e dëshmitarëve për heqjen dorë shprehimisht në marrëveshje midis tyre dhe me pëlqimin tim nga të paraqiturit, është mbledhur asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme e ortakëve të vetë shoqërisë.

Kryesinë e asamblesë e merr, në bazë të nenit 12 të Statuti të Shoqërisë, Presidente e Këshillit Administrativ znj. Crippa Silvia, administratore, lindur në Bergamo (Bg) më 5 mars 1960 dhe rezidente në Torre Boldone (Bg) rruga Reich nr. 88, për identitetin e së cilës jam i bindur, e cila në çelje të seancës thekson se asambleja e sotme është thirrur me njoftimin e publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Italiane të datës 10 shtator 2004 Nr. 213 Fletë Njoftime përkatëse, në datë 28 shtator 2004 ora 18.



NO
VLCF

“1. Modifikime dhe shtesa në statutin e shoqërisë me qëllim adoptimin me dispozitat e dekretit legjislativ nr. 6/2003 “Reformat e ligjit për shoririnë”;

2. Vendime në lidhje dhe vijuese për sa më sipër;

3. Të ndryshme dhe përfundimtare.

Kështu Asambleja emëron sekretarin e vet mua noterin që pranoj. Kështu pasi themelohet zyra e Kryesisë së asamblesë, Presidenti konstaton:


- Se rezultojnë të regjistruar në Librin e Ortakëve 7 Ortakë;
- Se janë të pranishëm personalisht në asamble 4 Ortakë, që përfaqësojnë 166.320 (njëqind gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet) të aksioneve nga totali i 200.000 aksioneve që përbëjnë kapitalin dhe konkretisht Zotërinjtë:
- Bacchin Gabriella titullarin e 10.380 (dhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë) aksioneve;
- Crippa Alessandro titullar i 150.150 (njëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) aksioneve;
- Di Fant Franco titullar i 2.380 (dymijë e treqind e tetëdhjetë) aksioneve;
- Zorzi Marcello titullar i 3.410 (tremijë e katërqind e dhjetë) aksioneve;
- Se kuota e kapitalit të 20.000 (njëzet mijë) aksioneve përfaqësohet nga aksionet e veta që titullarë është vetë Shoqëria;
- Se është i pranishëm Këshilli Administrativ personalisht dhe në prani të Zotërinjve;

Crippa Alessandro, Bacchin Gabriella, Zorzi Marcello dhe Di Fant Franco

- Se është i pranishëm Kolegji Auditues i përbërë nga Zotërinjtë: Sandali dot. Sergio, President; Contessotto dot. Marco dhe Perazzetta Antonella llogaritar, Auditues Efektiv;
- Se aksionet janë depozituar në bazë të ligjit;

Për sa më sipër asambleja rezulton e kostituar rregullisht dhe e vlefshme për të vendosur për çështjet në Rend të Ditës.

Duke kaluar në temën e Rendit të Ditës Presidenti u ka paraqitur të pranishmeve nevojën e procedimit për adoptimin e një teksti të ri të statudit për përshtatjen e normativës së parashikuar në Dekretin Legjislativ të 17 janarit 2003.



Asambleja, pasi ka dëgjuar prezantimin nga Presidenti: në mënyrë unanime

Vendos:

- Të aprovojë tekstin e ri të Statutit të Shoqërisë që transkribohet në mënyrë integrale këtu si më poshtë vijon:

STATUTI I SHOQËRISË

Neni 1 – Është formuar një shoqëri aksionare me emërtimin “**KONSTRUKSIONE INDUSTRIALE CIVIDAC SHA**”.

Neni 2 – Shoqëria e ka selinë ligjore në Komunën e San Biagio di Callalta (TV).


Organi Administrativ mund të institujë ose të heq, si në Itali ashtu edhe jashtë shtetit seli dytësore, agjenci, degë, filiale dhe zyra përfaqësimi si dhe gjithashtu të transferoj selinë në territorin kombëtar.

Rezidenca e çdo ortaku, për marrëdhëniet me shoqërinë, është ajo e regjistruar nga libri i ortakëve.

Neni 3 – Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar më 31 dhjetor 2050; shoqëria mund të zgjerohet ose të shpërbëhet paraprakisht, me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve.

Neni 4 - Shoqëria ka si objekt kryerjen e konstruksione industriale në metal, kaldaja në përgjithësi, si për llogari të vetë ashtu edhe për llogari të palëve të treta. Shoqëria jo kryesisht dhe plotësisht në mënyrë rastësore dhe instrumentale për arritjen e objektit të shoqërisë, mund të kryejë të gjitha aktivitetet tregtare, financiare, industriale, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të japë fidejussioni dhe hua bankare, dhe garanci në përgjithësi, edhe në favor të palëve të treta, si dhe gjithashtu edhe të marrë, vetëm me qëllim investimi të qëndrueshëm dhe jo të vendosjes në treg, si në mënyrë të drejtpërdrejt, si në mënyrë të tërthortë, pjesëmarrje dhe interesa në shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt ose qëllim analog ose të lidhur me atë të tyre në përputhje me normativën në fuqi dhe jo kundrejt publikut.

Shoqëria mund të marrë mandate, përfaqësime kombëtare dhe të huaja, me ose pa depozita, të produkteve të lidhura me objektin e shoqërisë; mund të marrë përsipër ushtrimin, edhe nëpërmjet kontratave të qirasë, të menaxhimit dhe likuidimit e ndërmarrjeve që kanë të njëjtat qëllime ose



qëllime të lidhura me ato të shoqërisë, gjithçka me veprimet që do të konsiderohen nga organi administrativ të nevojshme ose të domosdoshme për vazhdimësinë e objektit të shoqërisë.

Neni 5 – Kapitali i shoqërisë është 104.000,00 euro (njëqind e katër mijë presje zero zero) e ndarë në numrin e 200.000,00 (dyqind mijë presje zero zero) aksione prej 0,52 euro (zero presje pesëdhjetë e dy) secila.

Aksionet do të përfaqësohen nga tituj aksionar.

Kapitali i shoqërisë duhet jepet në të holla. Në përputhje me vendimin e asamblesë së ortakëve mundet gjithashtu të jepet në natyrë ose përmes kontributit të kredisë; në këto raste, kontribuuesi do të duhet të prezantojë një relacion vlerësues në bazë të nenit 2343 të Kodit Civil.


Secilit ortakë i është caktuar një numër aksionesh proporcionale nga pjesa e kapitalit të nënshkruar dhe në një vlerë jo më të madhe se kontributi i tij.

Kapitali mund të shtohet me pagesë (nëpërmjet kontribute të reja në të holla ose në natyrë) ose falas (nëpërmjet një kalimi të kapitalit rezervë ose fonde të tjera në dispozicion) në bazë të vendimit të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve, përveç për sa parashikohet në paragrafin tjetër të gjashtë.

Asambleja, me një rezolutë të veçantë të miratuar në një seancë të jashtëzakonshme, mund t'i atribuojë organit administrativ kompetencën për të shtuar një ose shumë herë kapitalin deri në një sasi të caktuar dhe për një periudhë maksimale të pesë viteve nga data e vendimit, megjithatë duke përjashtuar të drejtën për të përjashtuar ose kufizuar të drejtën e opsionit, përmendur në paragrafin e tetë. Vendimi i shtimit të kapitalit të shoqërisë e marrë nga organi administrativ në zbatim të delegimit në fjalë, duhet të rezultojë nga proces verbali i redaktuar nga noteri.

Shtimi i kapitalit të shoqërisë nuk mund të zbatohet deri sa aksionet e emetuara më parë të jenë paguar plotësisht.

Në rast të vendimi të shtimit të kapitalit të shoqërisë domethënë të emetimit të obligacioneve të konvertuara në aksione i përket ortakëve e drejta e zgjedhjes si dhe e drejta e parablerjes në aksione dhe /ose obligacioneve të konvertueshme që kanë mbetur regjistruara; nëse ka obligacione të konvertueshme, e drejta e opsionit i përket edhe poseduesve të tyre, në konkurrencë me ortakët,



në bazë të raportit të këmbimit. Aplikohet dispozita e nenit 2441 Kodit Civil. Mund të përjashtohen si në depozitimin në Regjistrin e ndërmarrjeve e ofertës të opsionit që çdo formë tjetër e publicitetit të së njëjtës, nëse të gjithë ortakët dhe posedues të obligacioneve të konvertueshme të jenë të pranishëm (vetë ose nëpërmjet delegimit) në asamble që vendos zgjerimin dhe deklarojnë që janë tashmë të informuar për ofertën e opsionit dhe të afatit përkatës.

Neni 6 – Shoqëria mund të emetojë kredi për bono të konvertueshme ose jo të konvertueshme.

Emetimi i obligacioneve të zakonshme vendoset nga organi administrativ, ndërsa emetimi i obligacioneve të konvertueshme vendoset nga asambleja e jashtëzakonshme.

Asambleja, me vendim të posaçëm të miratuar në një seancë të jashtëzakonshme, mund t'i atribuojë organit administrativ kompetencën e emetimit një ose shumë herë të obligacioneve të konvertueshme deri në një sasi të caktuar dhe për një periudhë maksimale deri në pesë vjet nga data e vendimit, me përjashtim gjithsesi të kompetencës së përjashtimit ose kufizimit të së drejtës së opsionit që u përket ortakëve ose poseduesve të obligacioneve të tjera të konvertueshme.

Aplikohen të gjitha dispozita e tjera të Seksionit VII kreu V Libri V të Kodit Civil.

Neni 7 – Aksionet janë të transferueshme në rast vdekje (mortis causa) dhe me akt midis të gjallëve midis ortakëve. Aksionet mund të jenë të transferueshme me akt midis të gjallëve tek jo anëtarët me autorizim paraprak të Administratorit të Vetëm ose të Këshillit Administrativ; nëse autorizimi i organit administrativ mohohet, u përket ortakëve e drejta e ndërprerjes në bazë të neneve 2437 e në vijim të Kodit Civil.

Neni 8 – Aksionet janë nominativë; secila prej tyre atribuon të drejtën e një votë përveç rastit nëse janë krijuar kategori të aksioneve, të pajisur me të drejta të ndryshme në bazë të paragrafit të katërt vijues, aksione që përballë njohjes së të drejtave të veçanta janë pa të drejtë vote ose me të drejtë vote të limituar.

Vlera e aksioneve të tilla nuk mund në total të tejkalojë gjysmën e kapitalit të shoqërisë.

Aksionet u japin poseduesve të tyre të drejta të njëjta.

Gjithsesi me vendim të posaçëm të asamblesë së jashtëzakonshme mund të krijohet kategori e posaçme e aksioneve të pajisura me të drejta të ndryshme në bazë të neneve 2348 e në vijim të



kodit civil; megjithatë të gjitha aksionet që i përkasin të njëjtës kategori japin të drejta të barabarta. Në rast të krijimit të kategorive të veçanta të aksioneve në fjalë, vendimet e asamblesë, që ndikojnë në të drejtat e njëres prej tyre, duhet të aprovohen edhe në asamblenë e posaçme që i përkasin kategorisë në fjalë. Në asamblenë speciale aplikohen dispozitat në lidhje me asamblenë e jashtëzakonshme.

Në rast të bashkëpronësisë së një aksioni, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqësues i përbashkët i emëruar sipas modaliteteve të parashikuara në nenet 105 dhe 1106 të Kodit Civil.

Në rast të pengu, uzufukt i ose sekuestrimi mbi aksione, aplikohet neni 2352 të Kodit Civil.


Për blerjen nga shoqëria të aksioneve të veta, për përmbushjen e veprimeve të tjera në aksionet e veta, dhe për blerjen e aksioneve nga shoqëri vartëse, aplikohen dispozitat e neneve 2357 e në vijim të kodit civil. Shoqëria vartëse nga shoqëri tjetër nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në asamblenë e saj. Shoqërive u ndalohet të konstitujnë ose të zgjerojnë kapitalin nëpërmjet nënshkrimit reciprok të aksioneve, edhe nëpërmjet shoqërive trust (të besimit) ose nëpërmjet pale të tretë.

Neni 9 – Kanë të drejtë të ndërhyjnë në asamble ortakët të cilëve u përket e drejta e votës dhe që në datën e vetë asamblesë rezultojnë të regjistruar në librin e ortakëve.

Ortakët që synojnë të marrin pjesë në asamble, edhe për qëllimet e detyrimeve të përmendura në paragrafin e tretë të nenit 2370 të Kodit Civil, duhet të ekspozojnë titujt aksionar me qëllim që të demonstrojnë ligjshmërinë e pjesëmarrjes dhe të votojnë në asamble. Nuk kërkohet depozitimi paraprak i aksioneve.

Çdo ortakë që të drejtën e ndërhyrjes në asamble mund të përfaqësohet edhe nga subjekt jo ortak në përputhje me nenin 2372 të kodit Civil, me delegim me shkrim, që duhet të ruhet nga shoqëria; nuk mund të lëshohet me emrin e të deleguarit në të bardhë dhe është gjithnjë i revokueshëm, pavarësisht çdo marrëveshje të kundërt.

Përfaqësimi nuk mund t'u jepet as anëtarëve të organit administrativ ose të kontrollit ose punonjësve të shoqërisë, as shoqërie në varësi të tyre ose anëtarëve të organeve administrative ose të kontrollit ose vartësve të tyre.



Aplikohen dispozitat e tjera të nenit 2372 të K.C.

Neni 10 – Ortakët mund të kryejnë, me kërkesë të organit administrativ dh në përputhje me dispozitat në fuqi me karakter fiskal, derdhje llogarie/kapitali ose financime me interes ose pa interes, që nuk përbëjnë mbledhje të kursimeve në publik në bazë të dispozitave në fuqi të ligjit në çështjet bankare dhe të kredisë.

Në rast të derdhjeve në llogarinë e kapitalit, shumat përkatëse mund të përdoren për mbulimin e çdo humbje ose transferuar në rritje të drejtpërdrejt të kapitalit të çdo shume, dhe kjo paraprakisht, në përputhje me rezolutën e aksionarëve.


Neni 11 – Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme në përputhje me ligjin dhe shqyrton kompetencat përkatëse sipas parashikimeve të ligjit.

Kompetencës së organit administrativ i atribuohen aktivitetet e mëposhtme:

- Vendimet në lidhje me bashkimin në rastet e parashikuara në nenet 2505 dhe 2505/a të K.C.
- Krijimin dhe heqjen e selive dytësore.
- Treguesin se cili nga administratorët ka përfaqësimin e shoqërisë.
- reduktimin e kapitalit të shoqërisë në rast tërheqje të ortaku
- adoptimin e statutit me dispozitat normative.
- Transferimin e selisë së shoqërisë në territorin kombëtar.

Asambleja duhet të thirret nga organi administrativ edhe me kërkesë të ortakëve në bazë të nenit 2367 të Kodit Civil, asambleja mblidhet pranë selisë së shoqërisë ose në vend tjetër por sidoqoftë në Itali. Në rast të pamundësisë së të gjithë administratorëve dhe të mosveprimit të tyre, asambleja mund të thirret nga Kolegji Auditues ose me kërkesë të ortakëve që përfaqësojnë të paktën një të dhjetën e kapitalit të shoqërisë dhe në kërkesë të paraqiten çështjet për t'u diskutuar.

Në bazë të nenit 2366 paragrafi i tretë K.C. asambleja thirret me njoftim që u komunikohet ortakëve, administratorëve dhe audituesve, nëpërmjet një letre rekomande me vërtetim marrje ose në dorë me nënshkrimin e faturës, dërguar atyre që kanë të drejtën e votës në adresën e banimit që rezulton në librat e shoqërisë, të paktën tetë ditë para nga data e përcaktuar për mbledhje; nëse



është e detyrueshme me ligj, asambleja thirret sipas parashikimeve në nenin 2366 paragrafi i dytë K.C

Posta elektronike ose Telefax-i mund të zëvendësojnë letrën rekomande me vërtetim marrje ose dorazi nëse këto mjete transmetimi sigurojnë provën e marrjes brenda afatit të caktuar në periudhën e mëparshme. Në këtë rast njoftimi i mbledhjes do të komunikohet në vendin dhe në adresën e-mail ose në numrin e përdoruesit Telefax të komunikuar nga ortakët, administratorët dhe audituesit tek shoqëria, që rezultojnë nga libri i shoqërisë.

Në njoftimin e thirrjes duhet të shënohet dita, vendi në të cilin do të zhvillohet mbledhja si dhe vende që lidhen me të në mënyrë elektronike, orën e grumbullimit dhe listën e çështjeve që do të trajtohen.


Në njoftim mund të parashikohet një datë e një mbledhje të dytë, nëse në mbledhja e mëparshme nuk rezulton e përbërë ligjërisht. Asambletë e grumbullimit të dytë duhet të jenë të përcaktuara me interval të paktën një ditë.

Edhe në mungesë të thirrjes formale, asambleja konsiderohet e përbërë rregullisht kur në të përfaqësohet i tërë kapitali i shoqërisë, merr pjesë shumica e anëtarëve të organit administrativ dhe të kontrollit dhe asnjë nuk kundërshton trajtimin e çështjeve për shkak të informimit të pamjaftueshëm. Në një rast të tillë duhet të komunikohen në kohë vendimet e marra anëtarëve të organit administrativ dhe të kontrollit që nuk janë të pranishëm, nëpërmjet një letre rekomande me vërtetim marrje, ose fax ose e-mail.

Neni 12 – Asambleja kryesohet nga Administratori i Vetëm ose nga Presidenti i Këshillit Administrativ ose nga Zëvendës Presidenti, nëse është emëruar, ose në mungesë të personave të sipërpërmendur, nga persona të tjerë të caktuar nga Asambleja me votën pro të shumicës së të pranishmëve.

Në rast se proces verbali nuk përpilohet nga një noter, asambleja emëron një sekretar edhe nëse nuk është ortak.

I përket presidentit të asamblesë të konstatojë përbërjen e rregullt të asamblesë, të konstatojë identitetin dhe legjitimitimin e të pranishmëve, të drejtojë dhe të organizojë zhvillimin e asamblesë dhe të konstatojë dhe të shpall rezultatet e votimeve.



Vendimet e asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal të nënshkruar nga presidenti dhe nga sekretari ose nga noteri nëse kërkohet me ligj.

Proces verbali duhet të tregojë datën e asamblesë, edhe bashkëlidhur, identitetin e pjesëmarrësve dhe kapitalin e përfaqësuar nga secili; duhet gjithashtu të tregojë modalitetet dhe rezultatin e votimeve dhe duhet të lejoj, edhe bashkëlidhur, identifikimin e ortakëve në favor, abstenues ose që nuk janë dakord. Në proces verbal duhet të përmbliidhet, me kërkesë të ortakëve, deklaratimet e tyre që i përkasin rendit të ditës.

Proces verbali i asamblesë së jashtëzakonshme duhet të hartohet nga një noter.

Proces verbali duhet të hartohet pa vonesa në kohën e duhur për ekzekutimin në afat të detyrimeve të depozitimit dhe publikimit.

Proces verbali i asamblesë, edhe nëse hartohet me akt publik, duhet të regjistrohet, pa vonesë, në Librin e Mbledhjeve dhe të vendimeve të asamblesë. Asambleja e ortakëve mund të zhvillohet edhe me pjesëmarrës të vendosur në disa vende të lidhura me audio video, në përputhje me kushtet në vijim, për të cilat duhet të mbahet akt në proces verbalet përkatëse

- Të jenë të pranishëm në të njëjtin vend presidenti dhe sekretari i mbledhjes të cilët do të sigurojnë formimin dhe nënshkrimin e proces verbalit;
- t'i lejohet presidentit të asamblesë të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e pjesëmarrësve, zhvillimin e rregullt të mbledhjes, të konstatojë dhe të shpall rezultatet e votimit;
- t'i lejohet subjektit që mban proces verbalin të perceptojë në mënyrë të përshtatshme ngjarjet e asamblesë që janë objekt i proces verbalit.
- t'u lejohet pjesëmarrësve të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin simultan për çështjet në rend të ditës, si dhe të për të parë, marrë dhe transmetuar dokumente;
- të paraqitet në njoftimin e mbledhjes, (përveç kur bëhet fjalë për asamblenë totalitare), vendet e lidhura me audio-video nga shoqëria, në të cilat pjesëmarrësit mund të marrin pjesë, duke pasur parasysh mbledhjen e mbajtur në vendin ku do të jenë të pranishëm presidenti dhe mbajtësi i proces verbalit.



Neni – 13 – Asambleja e zakonshme dhe e jashtëzakonshme konstituohet në mënyrë të vlefshme dhe merr vendim me kuorumin e parashikuar nga ligji.

Neni 14 – Shoqëria administrohet ose nga një Administrator i Vetëm ose nga një Këshill Administrativ të përbërë nga tre ose shtatë anëtarë, të zgjedhur nga Asambleja, që herë pas here, përpara se të procedojë me votimin, do të përcaktojë numrin e anëtarëve të vetë Këshillit në kufijtë e sipërpërmendur.

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit çdo ortakë mund të propozoj një ose më shumë kandidatë dhe do të zgjidhen administratorë, në numrin e përcaktuar nga Asambleja, ata që do të marrin numrin më të madh të votave.

Neni 15- Administratorët kanë mandat tre vite ushtrimore dhe mund të ri zgjidhen.

Administratori që heq dorë nga detyra duhet të njoftojë me shkrim Këshillin Administrativ dhe Presidentin e Kolegjit Auditues. Heqja dorë ka efekt të menjëhershëm, nëse ka mandat shumica e Këshillit Administrativ, ose, në rast të kundërt, nga momenti në të cilin shumica e Këshillit të ri themelohet në vijim të pranimit të administratorëve të rinj.

Përfundimi i mandatit të administratorëve për shkak të skadencës së afateve, ka efekt nga momenti në të cilin Këshilli Administrativ është ri themeluar.

Përfundimi i mandatit të administratorëve nga detyra për çfarëdolloj shkak duhet të regjistrohet brenda tridhjetë ditëve në regjistrin e bizneseve nën këqyrjen e Kolegjit Auditues

Nëse gjatë vitit ushtrimor mungojnë një ose më shumë administrator, të tjerët do të sigurojnë zëvendësimin me vendim të aprovuar nga Kolegji Auditues, nëse shumica do të jetë gjithnjë e kostituuar nga administratorë të emëruar nga asambleja. Kështu Administratorët e emëruar në këtë mënyrë qëndrojnë në detyrë deri në asamblenë e ardhshme.

Nëse nuk ka shumicë të administratorëve, ata që kanë ngelur në detyrë duhet të thërrasin asamblenë me qëllim që të bëj zëvendësimin e mungesave.

Administratorët e emëruar nga asambleja përfundojnë mandatin së bashku me administratorët në detyrë me aktin e emërimit të tyre.



Nëse përfundon mandati i Administratorit të Vetëm ose i të gjithë administratorëve, asambleja për zëvendësimin e atyre që mungojnë duhet të thirret me urgjencë nga Kolegji Auditues, i cili ndërkohë mund të kryejë aktet e administrimit të zakonshëm.

Neni 16 – Këshilli Administrativ, nëse Asambleja nuk e ka parashikuar një gjë të tillë, zgjedh midis anëtarëve të saj një President dhe ndoshta një Zëvendës President.

Neni 17 – Këshilli Administrativ mblidhet në vendin e treguar në njoftimin e mbledhjes, si në selinë e shoqërisë ashtu edhe në vend tjetër, por sidoqoftë në Itali, nga Presidenti, edhe në vijim të kërkesës nga një anëtar i saj ose të një audituesi.

Thirrja, që përmban çështjet për t'u trajtuar, do të bëhet nga Presidenti i Këshillit Administrativ nëpërmjet letre rekomande ose telegrami ose fax -i ose poste elektronike të dërguar të paktën pesë ditë para mbledhjes, dhe në raste urgjente, me telegram ose fax ose poste elektronike të dërguar të paktën dy ditë para në vendbanimin e secilit këshilltarë ose Auditues. Telefax-i do të dërgohet në numrin e komunikuar nga administratorët dhe audituesit tek shoqëria ose nëse njoftimi bëhet nëpërmjet postës elektronike, në adresën e-mail të paraqitur nga të njëjtët dhe që rezulton nga shënimi i duhur i raportuar në librin e Mbledhjeve dhe vendimeve të Këshillit Administrativ.

Këshilli duhet të konsiderohet rregullisht i kostituuar, edhe në mungesë të thirrjes formale kur janë të pranishëm të gjithë Këshilltarët dhe anëtarët efektiv të Kolegjit Auditues.

Mbledhja kryesohet nga presidenti i këshillit administrativ, i cili emëron një sekretar; ai harton procesverbalin e mbledhjes, që duhet të nënshkruhet nga ai dhe nga presidenti.

Vendimet e këshillit do të jenë të vlefshme kur është e pranishme shumica e këshilltarëve dhe do të merret shumica absolute e votave të të pranishmëve.

Në rast barazimi të votave, vota e Presidentit është mbizotëruese.

Mbledhjet e këshillit administrativ mund të zhvillohen edhe në audio -video konferenca me pjesëmarrës që ndodhen në disa vende të lidhura me audio-video, në përputhje me kushtet në vijim, për të cilat duhet të mbahet akt në proces verbalet përkatëse



- Të jenë të pranishëm në të njëjtin vend presidenti dhe sekretari i mbledhjes të cilët do të sigurojnë formimin dhe nënshkrimin e proces verbalit; të konsiderohet e zhvilluar mbledhja në vendin në fjalë.
- t'i lejohet presidentit të këshillit administrativ të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e pjesëmarrësve, zhvillimin e rregullt të mbledhjes, të konstatojë dhe të shpall rezultatet e votimit;
- t'i lejohet subjektit që mban proces verbalin të perceptojë në mënyrë të përshtatshme ngjarjet e asamblesë që janë objekt i proces verbalit.
- t'u lejohet pjesëmarrësve të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin simultan për çështjet në rend të ditës, si dhe të për të parë, marrë dhe transmetuar dokumente;
- të paraqitet në njoftimin e mbledhjes, (përveç kur bëhet fjalë për asamblenë totalitare), vendet e lidhura me audio-video nga shoqëria, në të cilat pjesëmarrësit mund të marrin pjesë, duke pasur parasysh mbledhjen e mbajtur në vendin ku do të jenë të pranishëm presidenti dhe mbajtësi i proces verbalit.


Vendimet e Këshillit Administrativ të adoptuara në bazë të këtij neni konstatohen nga proces verbali i nënshkruar nga Presidenti dhe nga sekretari: ky procesverbal, edhe nëse hartohet me akt publik, duhet të regjistrohet në Librin e Mbledhjeve dhe vendimeve të Këshillit Administrativ.

Neni 18 - Administratori i Vetëm ashtu si edhe Këshilli Administrativ ka kompetencat më të gjera për të gjitha aktet administrative të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të shoqërisë; dhe në veçanti i njihen të gjitha kompetencat për arritjen e qëllimeve të shoqërisë që nuk i janë nga ligji dhe nga ky Statut të rezervuara detyrimisht Asamblesë.

Këshilli Administrativ me shumicën e anëtarëve të tij në detyrë mund të delegojë kompetencat e veta, në kufijtë e lejuar nga ligji, një komiteti ekzekutiv, të përbërë nga disa anëtarë të tij, ose njërit ose më shumë Drejtorëve Administrativ, duke përcaktuar kufijtë dhe modalitetet e ushtrimit të delegimeve të dhëna në këtë mënyrë.

Autorizimi i parashikuar nga neni 2390 i K.C. duhet të jepet me vendim nga Asambleja me shumicë të cilësuar të 51%.

Neni 19 - Administratorit të Vetëm ashtu si edhe Presidentit të Këshillit Administrativ i përket nënshkrimi i shoqërisë dhe përfaqësimi ligjor i shoqërisë në marrëdhënie me palët e treta.



Organi administrativ mund të emërojë drejtorë dhe të jap prokura të posaçme personave që janë të huaj për shoqërinë për ekzekutimin e akteve të veçanta ose për kategori aktesh.

Neni 20 - Administratorit të Vetëm ose anëtarëve të Këshillit Administrativ u përkasin kompensime në masë të caktuar dhe /ose në pjesëmarrjen e fitimeve dhe / ose në përqindjen e xhiros në masën e caktuar nga Asambleja e Ortakëve; administratorëve me detyra të veçanta u përket një kompensim që do të përcaktohet në përputhje me nenin 2389 të K.C., nga Këshilli Administrativ, duke marrë parasysh mendimin e Kolegjit Auditues dhe/ose, nëse Organi Administrativ e konsideron se duhet t'ia dërgojë vendimin, Asamblesë së Ortakëve. Mund të njihet gjithashtu në favor të Administratorit të Vetëm ose të administratorëve të ngarkuar me detyra të veçanta, një kompensim i përfundimit të marrëdhënies në masën që Asambleja e Ortakëve do të konsiderojë të përshtatshëm.

Administratorët kanë të drejtë rimbursimi të shpenzimeve të mbajtura për arsye të detyrës së tyre, me paraqitjen e dokumentacionit të përshtatshëm.


Neni 21 – Kolegji Auditues është organi i vetëm i kontrollit, të cilit i përket:

- të mbikëqyrë pajtueshmërinë e ligjit dhe të statutit, në përputhje me parimet e administrimit korrekt dhe në veçanti në pajtueshmërinë e strukturës organizative, administrative dhe kontabilitetit të përshtatur nga shoqëria dhe mbi funksionimin konkret të saj.
- Të ushtrojë kontrollin e kontabilitetit, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 2409/a të Kodit Civil, aplikimi i të cilave zbatohet në nenin 22 në vijim.;

Kolegji Auditues përbëhet nga tre anëtarë efektiv dhe dy plotësues, të emëruar për herë të parë në aktin themelues dhe më pas nga asambleja e zakonshme e ortakëve. Ata qëndrojnë në detyrë për tre vite ushtrimor dhe përfundojnë në datën e asamblesë së thirrur për miratimin e bilancit përkatës të vitit ushtrimor të tretë të mandatit. Përfundimi i audituesve për shkak të skadimit të afatit ka efekt nga momenti në të cilin kolegji është ri konstituuar, audituesit mund të rizgjidhet. Presidenti emërohet nga asambleja e ortakëve, me vendimin e emërimit të vetë kolegjit.

Kolegji Auditues ka kompetenca të përmendura në nenin 2403/a të Kodit Civil.

Nuk mund të emërohen në detyrën e Kryetarit dhe nëse janë emëruar bien nga detyra ata që gjenden në kushtet e parashikuara nga neni 2399 të kodit civil.



Tarifa vjetore të audituesve përcaktohet nga asambleja e ortakëve në aktin e emërimit për gjithë periudhën kohëzgjatjes së mandatit të tyre.

Kolegji Auditues duhet të mbledhet të paktën çdo nëntëdhjetë ditë. Për modalitetet e thirrjes të Kolegjit aplikohen dispozitat nenit të mëparshëm 13. Janë gjithsesi të vlefshme mbledhjet e kolegjit Auditues dhe vendimet e tij, edhe pa thirrjen formale, kur marrin pjesë të gjithë audituesit efektiv në detyrë. Mbledhjet Kolegjit Auditues mund të mbahen me pjesëmarrës që gjenden në vende të lidhura me audio-video, dhe kjo me kushtet e mëposhtme, për të cilat duhet mbajtur akt në procesverbalet përkatëse:


- a) T'i lejohej Presidentit të mbledhjes të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e pjesëmarrësve, dhe të organizojë zhvillimin e rregullt të mbledhjes dhe t'i lejohej subjektit që mban proces verbalin të perceptojë në mënyrë të përshtatshme ngjarjet që janë objekt i proces verbalit.
- b) t'u lejohej pjesëmarrësve të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin simultan për çështjet në rend të ditës, si dhe të për të parë, marrë dhe transmetuar dokumente;

Kolegji Auditues është rregullisht i kostituuar me praninë e shumicës së audituesve dhe vendos me shumicë absolute të të pranishmëve.

Për mbledhjet e Kolegjit duhet të përpilohet proces verbal, që duhet të regjistrohet në librin e mbledhjeve dhe vendimeve të Kolegjit Auditues dhe të nënshkruhet nga pjesëmarrësit. Kryetari që nuk bie dakord ka të drejtë të regjistrojë në proces verbal shkaqet e mospajimit të tij.

Audituesit duhet të asistojnë në asamblenë e ortakëve, në mbledhjet e këshillit administrativ dhe në mbledhjet e çdo komiteti ekzekutiv. Çdo ortak mund të raportojë faktet që konsideron të dënueshme në kolegjin Auditues, i cili duhet të marrë parasysh këtë raport në relacionin vjetor të bilancit, nëse raportimi është bërë nga shumë ortakë që përfaqësojnë një të njëzetën e kapitalit të shoqërisë Kolegji Auditues duhet të hetoj pa vonesë mbi faktet e denoncuar dhe të prezantojë konkluzionet e veta dhe çdo propozim në asamble.

Për sa është i ngarkuar me kontrollin e kontabilitetit Kolegji Auditues, në përputhje me nenin 2409/a paragrafi i fundit i Kodit Civil, duhet të kostitohet plotësisht nga Revizorë Kontabiliteti të regjistruar në Regjistrin e krijuar pranë Ministrisë së Drejtësisë.



Neni 22 – Audituesi ose shoqëria e ngarkuar me kontrollin e kontabilitetit, edhe nëpërmjet shkëmbimeve të informacionit me kolegjin Auditues:

- verifikon periodikisht gjatë vitit ushtrimor, të paktën tremujor, rregullsinë e mbajtur të kontabilitetit të shoqërisë dhe njohja e saktë në të dhënat e kontabilitetit të fakteve të menaxhimit;
- verifikon nëse bilanci i vitit ushtrimor dhe ku janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara korrespondojnë me rezultatet e të dhënave të kontabilitetit dhe kontrollet e kryera dhe nëse janë në përputhje me dispozitat që i rregullojnë.
- Shpreh me një raport përkatës një gjykim mbi bilancin e vitit ushtrimor dhe mbi bilancin e konsoliduar aty ku përgatiten.


Kryerja e kontrollit të kontabilitetit shënohet në një libër të veçantë që mbahet pranë selisë së shoqërisë.

Asambleja, me emërimin e revizorit, duhet edhe të përcaktojë edhe tarifën për të gjithë kohëzgjatjen e detyrës, që nuk mund të tejkaloj tre vite ushtrimor. Audituesi ose shoqëria audituese duhet të posedojnë për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre kërkesat e nenit 2409 d të Kodit Civil; në rast të kundërt mund të zgjidhen ose të jenë të privuar nga e drejta, në rast të revokimit të audituesit, administratorët duhet të thërrasin pa vonesë asamblenë për emërimin e audituesit të ri.

Audituesit pushojnë nga detyra e tyre me miratimin e bilancit të vitit të fundit ushtrimor dhe mund të ri zgjidhen.

Neni 23 - Viti ushtrimor mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti. Brenda kufijve dhe formave të ligjit, organi administrativ do të sigurojë përpilimin e Bilancit të vitit ushtrimor në përputhje me ligjin.

Bilanci duhet të miratohet me vendim të asamblesë së zakonshme brenda njëqind e njëzet ditë nga mbyllja e vitit ushtrimor të shoqërisë ose brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve në rast se shoqëria duhet të hartojë bilancin e konsoliduar dhe kur nevoja të veçanta në lidhje me strukturën dhe objektin e shoqërisë e kërkojnë; në këtë rast të fundit për më tepër administratorët duhet të shënojnë në raportin e tyre mbi menaxhimin (ose në shënimin shpjegues në rast të bilancit të hartuar në formë të shkurtuar) shkaqet e zgjerimit.



Nga fitimet neto që rezultojnë nga bilanci duhet të zbritet një shumë që i korrespondon 5% (pesë për qind) që është e destinuar për rezervën ligjore derisa kjo nuk do të arrijë një të pestën e kapitalit të shoqërisë.

Mund të shpërndahen ekskluzivisht fitimet aktuale dhe ato

Që rezultojnë nga bilanci i miratuar rregullisht, zbritje e kryer nga kuota e destinuar për rezervën ligjore.

Nëse konstatohet një humbje e kapitalit të shoqërisë, nuk mund të kryhet shpërndarja e fitimeve derisa kapitali nuk rivendoset ose reduktohet në masën që korrespondon.

Neni 24 – Klauzolë e arbitrazhit

